



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 98 Prot

Tiranë, më 04, 06, 2012

VENDIM Nr. 205, datë 04.06.2012

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 04.06.2012, pasi shqyrtoi relacionin mbi procedurat e licencimit të individëve dhe subjekteve private në arkeologji, si dhe propozimet për disa ndryshime dhe përmirësime në Rregulloren e KKA,

VENDOSI:

- I. Të miratojë propozimet për disa ndryshime dhe përmirësime në Rregulloren e KKA, sipas **Aneks 1**, bashkëlidhur vendimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA
ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al



ANEKS 1

Mbi disa ndryshime dhe përmirësime në “Rregulloren mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut; kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike; kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe subjekte privatë”, si më poshtë:

1. Neni 10, llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, të shtohet:

B1. Survey dhe sondazh arkeologjik nënujor

B2. Gërmim arkeologjik nënujor

2. Neni 11, pika 3, të shtohet togëfjalëshi:

Nuk është e vlefshme asnjë lloj licence në fushën e arkeologjisë, dhënë nga institucione të huaja “e pakonfirmuar nga KKA”.

3. Neni 11, pas pikës 3, të shtohet pika 4:

Shtetasit e huaj trajtohen njësoj me shtetasit shqiptarë në procesin e pajisjes me licencë për veprimtari arkeologjike.

4. Neni 13, Arsimi dhe eksperiencia: Për të përftuar licensën A1, individi duhet të jetë i pajisur me:, në pikën e tretë të shtohet:

Eksperiencë si autor dhe/ose bashkëautor në të paktën 3 (tre) projekte arkeologjike brenda dhe/ose jashtë vendit e vërtetuar (kopje e projektit ose raportit përfundimtar të depozituar në institucionin që ka dhënë miratimin).

5. Neni 13, Arsimi dhe eksperiencia: Për të përftuar licensën A2, individi duhet të jetë i pajisur me:, në pikën e tretë të shtohet togëfjalëshi:

Eksperiencë si autor dhe/ose bashkëautor në të paktën 3 (tre) projekte arkeologjike brenda dhe/ose jashtë vendit e vërtetuar (kopje e projektit ose raportit përfundimtar të depozituar në institucionin që ka dhënë miratimin).

6. Neni 13, Licenca e tipit B, të shtohet:

B. Projektim e zbatim për veprimtari arkeologjike nënujore.

Tipi. Drejtues projekti

Arsimi dhe eksperiencia:



Për të përftuar liçensën B1(Arkeologji nënujore), individi duhet të jetë i pajisur me:

- Diplomë të shkollës së lartë në fushën histori- arkeologji ose diplomë universitare të huaj, e cila të jetë e njohur nga MASH e barazvlefshme me diplomën e sipërpërmendur.
- Diplomë shkolle pasuniversitare (master i nivelit të dytë) brenda dhe jashtë vendit, të njohur nga MASH, në arkeologji nënujore.
- Gradën e tretë të zhytësit, ose superiore, të mbrojtur me një nga didaktikat e njohura në të gjithë botën si SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- Personi që do të liçensohet duhet të demonstrojë që gjatë punës së tij nën ujë do të jetë gjithmonë i shoqëruar nga të paktën një zhytës me gradën e dytë, ose superiore, të didaktikave SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- Të ketë sigurimin për jetën në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytësave DAN EUROPE.
- Eksperiencë si autor dhe/ose bashkautor në të paktën tre projekte arkeologjike nënujore brenda dhe/ose jashtë vendit e vërtetuar (kopje e projektit ose raportit përfundimtar të depozituar në institucionin që ka dhënë miratimin).

7. Neni 13, Liçenca e tipit B, të shtohet:

Arsimi dhe eksperiencia:

Për të përftuar liçensën B2, individi duhet të jetë i pajisur me:

Arsimi dhe eksperiencia:

Për të përftuar liçensën B2, (Arkeologji nënujore)

- Diplomë të shkollës së lartë në fushën histori- arkeologji ose diplomë universitare të huaj, e cila të jetë e njohur nga MASH e barazvlefshme me diplomën e sipërpërmendur.



- Diplomë shkolle pasuniversitare (master i nivelit të dytë) brenda dhe jashtë vendit, të njohur nga MASH, në arkeologji nënujore.
- Gradën e tretë të zhytësit, ose superiore, të mbrojtur me një nga didaktikat e njohura në të gjithë botën si SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- Personi që do të liçensohet duhet të demonstrojë që gjatë punës së tij nën ujë do të jetë gjithmonë i shoqëruar nga të paktën një zhytës me gradën e dytë, ose superiore, të didaktikave SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- Të ketë sigurimin për jetën në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytësve DAN EUROPE.
- Eksperiencë si autor dhe/ose bashkautor në të paktën tre projekte arkeologjike nënujore brenda dhe/ose jashtë vendit e vërtetuar (kopje e projektit ose raportit përfundimtar të depozituar në institucionin që ka dhënë miratimin).
- Grada Doktor në fushën e arkeologjisë dhe nëndegët e saj brenda ose jashtë vendit, e njohur nga MASH.

8. Neni 13, pas paragrafit që përcakton dokumentacionin e nevojshëm për t'u pajisur me Liçencë të tipit B2 (arkeologji nënujore), të shtohen specifikimet e mëposhtme:

Kërkuesi i liçencës duhet të vërtetojë se në momentin e aplikimit është procesin e ndjekjes së programit të doktoraturës.

Nëse brenda një afati kohor prej 3 (tre) vjetësh pas marrjes së liçencës, individi nuk përfundon doktoraturën, i anulohet liçenca e dhënë nga KKA.

9. Neni 17, pas pikës 8, të shtohet pika 9:

Ambiente të sigurta të mbrojtura 24orë apo të survejuara nga kamera sigurie, për depozitimin e gjetjeve të luajtshme arkeologjike.

SEKRETARIA TEKNIKE E KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARKEOLOGJISË

ENINA POÇI